



**REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**Kuvendi Komunal Dragash – Skupština Opštine Dragaš – Municipality of Dragash**

**- Kuvendi Komunal**

**01 Nr.020-588/1-09/ 320-255**

**Dt. 03.11. 2010**

**D r a g a s h**

Kuvendi Komunal i Dragashit, n seancën e dt.02.11.2010, duke shqyrtuar kërkesën 09 Nr.320-255 të z.Zadin Qafeshi nga Bellobradi adresuar Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të KK-së Dragash, të drejtuar Drejtoratit për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit të KK-së lidhur me ndryshimin e destinimit të tokës, nga ajo bujqësore në ndërtimore (ndërtimi i pompës së benzinës), miraton këtë :

## **V E N D I M**

- I. **AUTORIZOHET** Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit të KK-së Dragash që, konform kërkesës dhe dokumentacionit të nevojshëm, sipas dispozitave ligjore lidhur me këtë çështje, të lëshon Aktvendimin përkatës për këtë qëllim.
- II. Parashtruesi i kërkesës **OBLIGOHET** që për Drejtoratin e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit të KK-së të siguron tërë dokumentacionin e nevojshëm për parcelën, ashtu siç e kërkojnë dispozitat ligjore për të cilat përkujdeset Drejtorati, përfshi edhe pagesën e taksave dhe kompenzimeve tjera të nevojshme për këtë destinacion.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin Komunal të Dragashit.

## **A r s y e t i m**

Kuvendi Komunal i Dragashit, në seancën e dt.02.11.2010, pas Informatës me arsyetimet e dhëna nga drejtori i Drejtoratit për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit të KK-së, vendosi në s ë pikën I të këtij Vendimi, duke autorizuar Drejtoratin që të zbaton procedurat e nevojshme ligjore, me lëshimin e Aktvendimit përkatës për parashtruesin e kërkesës.

Shtojcë: Informata e Drejtoratit...

I dërgohet :

- Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit të KK-së, drejtorit Bean Haxhihasan,
- Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të KK-së, drejtorit Bajram Hoxha,
- Parashtruesit të kërkesës z.Zadin Qafeshi, dhe
- Arkivit

**KUVENDI KOMUNAL-DRAGASH**

**Kryesuesi**

*Lulzim Rifa*

